

TREGTIA E JASHME E MALLRAVE

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

INSTAT

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshtësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	6
11. Manaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	10
15. Koherenca dhe Krahueshmëria.....	10
16. Kostoja dhe ngarkesa	11
17. Rishikimi i të dhënave.....	11
18. Përpunimi statistikor	11
19. Komente.....	13
Aneks	13

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Tregtisë së Jashtme, Drejtoria e Statistikave Sektoriale
1.3. Personi i kontaktit	Erjola Gjika (Karpuzi)
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës Sektori
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Njësia Administrative Nr.2, 1017, Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	ekarpuzi@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	19.01.2026
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	19.01.2026
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	19.01.2026
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave janë një instrument shumë i rëndësishëm për marrësit e vendimeve në sektorët publik dhe privat. Ato ndihmojnë në përgatitjen e bisedimeve bilaterale dhe multilaterale në kuadrin e politikave tregtare dhe për vlerësimin e ekonomive të tregut. Ato ndihmojnë kompanitë në studimin e tregut dhe në përcaktimin e strategjive të tyre tregtare. Këto statistika kanë rëndësi jo vetëm për këto marrëdhënie, por njëkohësisht janë një instrument i rëndësishëm për statistikën e tjera. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në statistikën e llogarive kombëtare, janë një element i rëndësishëm në Bilancin e Pagesave (BOP) etj. Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave kanë qëllim të japin të dhëna mbi tregtinë e mallrave dhe eksport-importin e mallrave në Shqipëri. Burimi kryesor i sigurimit të të dhënave statistikore të Tregtisë së Jashtme të Mallrave është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Informacioni mbledhet çdo muaj, nëpërmjet Deklaratës Doganore. Kjo deklaratë siguron të dhëna të nevojshme, si për qëllime doganore, ashtu dhe për qëllime statistikore dhe mbledh të dhëna statistikore për periudhën e kryerjes së transaksionit, për llojin e mallit, peshën neto, peshën bruto, vlerën statistikore të mallit, vendin destinacion, vendin eksportues, vendin origjinë, tipin e transaksionit, llojin e koncesionit, etj.

3.2. Sistemi i klasifikimit	Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave botohen në nivel vendi, sipas shteteve/grupeshteteve, në nivel 2 shifror dhe të grupuara sipas 21-seksioneve dhe 9 grup-mallrave të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave (NKM): Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave përpunojnë të dhënat e eksportit/importit edhe sipas 9 grupeve të Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Tregtisë (SITC). Statistikat e tregtisë së jashtme përpunohen edhe sipas karakteristikave të ndërmarrjeve duke përdorur edhe Nomenklaturën e Aktiviteteve Ekonomike dhe Nomenklaturën e Produkteve. Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave përpunojnë të dhënat e importit/eksportit edhe sipas disa klasifikimeve të tjera të përdorura për nevojat e sektorëve të tjerë në INSTAT dhe institucioneve të ndryshme si p.sh. Klasifikimi sipas Kategorive Ekonomike.
3.3. Mbulimi i sektorit	Përfshihen të gjithë sektorët që tregtojnë mallra.
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	Përkufizimet kryesore të treguesve të përdorur dhe publikuar në statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave. Eksportet: Këto janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor ose të përpunimit pasiv ose të ri-eksportuara pas përpunimit aktiv. Importet: Këto janë në përgjithësi mallra që vijnë nga një vend i tretë dhe të vendosura direkt ose qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor. F.O.B (I lirë në bord): Një kusht i shpërndarjes së mallrave që tregon se çmimi i mallrave përfshin edhe shpenzimet e transportit dhe të dorëzimit tek një port i caktuar i ngarkimit. C.I.F. (Kosto, Sigurim, Transport): Një kusht i shpërndarjes së mallrave që tregon që çmimi i mallrave përfshin sigurimin dhe transportin deri tek një port i caktuar destinacion. Sistemi tregtar i përgjithshëm regjistron të gjitha mallrat që hyjnë ose dalin nga territori ekonomik i një vendi, duke përjashtuar vetëm mallrat në tranzit. Pra në këtë rast regjistrohen si import të gjitha mallrat që hyjnë në magazinat doganore të një vendi, edhe në rast se nuk dalin në qarkullim të lirë në këtë vend. Në të njëjtën kohë të gjitha mallrat që dalin nga magazina doganore e një vendi regjistrohen si eksport i këtij vendi. Sistemi tregtar i veçantë është koncept më i ngushtë. Në këtë rast të gjitha mallrat që hyjnë në magazinat doganore të një vendi nuk regjistrohen si import i këtij vendi. Këto mallra regjistrohen si import vetëm në rast se kalojnë në qarkullim të lirë në këtë vend ose vendosen nën procedurën doganore për përpunim aktiv. Në mënyrë të ngjashme nuk regjistrohen si eksport të gjithë mallrat që dalin nga magazinat doganore.

3.5. Njësia statistikore	Çdo person fizik dhe juridik që depoziton deklaratën doganore.
3.6. Popullata statistikore	Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave regjistrojnë të gjitha mallrat, të cilat shtojnë ose pakësojnë burimet materiale të një vendi nëpërmjet hyrjeve (importeve) ose daljeve (eksporteve) nga territori ekonomik i tij, duke përfshirë edhe mallrat për përpunim. Informacion mbi mallrat jepet nga persona fizik ose juridik.
3.7. Zona e referencës	Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave mbulojnë flukset tregtare që hyjnë se dalin nga territori statistikor i Shqipërisë (nivel vendi).
3.8. Mbulimi në kohë	Seritë kohore të të dhënave vjetore të tregtisë në baza të qëndrueshme për shumicën e agregateve, janë të disponueshme elektronikisht që nga viti 1991. Seritë kohore të të dhënave mujore të tregtisë në baza të qëndrueshme për shumicën e agregateve, janë të disponueshme elektronikisht që nga viti 2005.
3.9. Periudha bazë	Të dhënat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave janë të publikuara nga viti 2005.
4. Njësia matëse	Vlera e tregtisë shprehet në lekë, milion lekë. Pesha neto në kg dhe sasia në njësinë suplementare (psh. m, m2, numri i artikujve), përdoren për të matur volumin tregtar.
5. Periudha e referencës	Ky raport i referohet të dhënave të vitit 2025. Periudha referuese për informacionin mbi të dhënat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave është muaji kalendarik i import/eksportit të mallrave. Në praktikë periudha e referencës është në përgjithësi muaji kalendarik gjatë të cilit është regjistruar deklarata doganore (data kur mallrat kalojnë kufirin) nga autoritetet doganore.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	Në nivel kombëtar, Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave janë bazuar në: • Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”; • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026; • Memorandumi i Mirëkuptimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Në nivel Evropian, Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave janë të bazuara në: • Rregulloren (KE) Nr 2019/2152 të Parlamentit Evropian; • Rregullorja e Komisionit (KE) Nr 2020/1197; • Rregullorja e Komisionit (KE) Nr 2021/1225; • Rregullorja e Komisionit (KE) Nr 2021/1704
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Marrëveshja me Eurostat për të shpërndarë të dhënat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave për Shqipërinë.

7. Konfidencialiteti

7.1. Konfidencialiteti - politika

Të dhënat e mbledhura për tregtinë e jashtme të mallrave konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, si dhe [Ligj Nr. 124/2024 për mbrojtjen e të Dhënave Personale](#). Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.

7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave

INSTAT mbron dhe nuk u shpërndan palëve të treta të dhënat e mbledhura nga, apo, tek të cilat ka akses, të dhëna këto që mund të shërbejnë në identifikimin drejtpërsëdrejti apo tërthorazi të njësive statistikore që i kanë ofruar të dhënat në fjalë për arsye dhe qëllime statistikore, apo të dhëna të marra nga burime të tjera administrative. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga Instituti i Statistikave vetëm në rast se:

- a) Këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor;
- b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave.

Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesit tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i Institutit të Statistikave. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërdahet dhe të bëhet publike nga Instituti i Statistikave, me qëllim që të bëhet i pamundur identifikimi i njësisë statistikore nga këto të dhëna; kriteret e anonimizimit për të dhënat mikro që u ofrohen përdoruesve; dhënia e aksesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore. INSTAT publikon të dhëna vetëm në nivel të agreguar. Në mënyrë që të mbrohet identiteti i tregtarit, totali i publikuar duhet të përfshijë të paktën 3 tregtarë në një qelizë, nga të cilët një tregtar nuk duhet të kalojë 85 % të vlerës totale. Vendim ndërkombëtar: Për mallrat e kapitullit 93 të NK, konfidencialiteti aktiv aplikohet direkt nga doganat: të gjitha kodet 8-shifrore të kapitullit 93 zëvendësohen me kodin NK 93000000 përpara se këto të dhëna ti dërgohen INSTAT-it.

8. Politika e botimit	
8.1. Kalendar i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Akses i kalendarin e publikimeve	Kalendar i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Akses i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr 17/2018, datë 17.04.2018 “Mbi Statistikat Zyrtare”, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë: 1. Website – online release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimi; 4. Kërkesa për të dhëna, seksioni për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshësia e shpërndarjes	Të dhënat e detajuara: Mujore dhe Vjetore; Të dhënat e agreguara: Mujore dhe Vjetore.
10. Akses i të dhënave dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Sipas kalendarit të publikimeve, çdo muaj publikohet njoftim për media mbi Tregtinë e Jashtme të Mallrave. Format i njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp i Tregtisë së Jashtme publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Të dhënat publikohen në faqen zyrtare të INSTAT sipas rregulloreve dhe ligjit referues: • Mujore: Tregtia e Jashtme; • Vjetore: Tregtia e Jashtme e Mallrave dhe Ndërmarrjet; • Vjetore: Shqipëria në Shifra; Ndërmarrjet e Huaja dhe të Përbashkëta.
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit ofrohet seria kohore për Tregtinë e Jashtme mujore dhe vjetore. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënave e aksesoni në linkun: Databaza Statistikore .

10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat mikro i jepen përdoruesve të veçantë pas plotësimit të formularëve standard. Këto të dhëna i jepen përdoruesve në rast se nuk janë konfidenciale bazuar në nenin 31 Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare. Në rast konfidencialiteti të dhënat fshihen në nivel të detajuar, që do të thotë se tregtari nuk lidhet me kodin ose partnerin real të produktit. Megjithatë është i përfshirë në tregtinë totale dhe në kapitullin e duhur, (në kodin e vërtetë HS2).
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për kërkesa për të dhëna .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me metodologjinë mbi vrojtimin.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Tregtisë së Jashtme dokumenton gjithë procesin dhe procedurat për qëllimet e brendshme.
11. Menaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane. INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës (kostos) së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Kontrollet e cilësisë dhe vlefësimi i të dhënave janë veprime që kryen përgjatë tërë procesit. Staf i përfshirë në fazat e ndryshme të përpilimit të të dhënave të tregtisë jashtme të mallrave, të tilla si mbledhja e të dhënave, kontrollet fillestare, hedhja e të dhënave dhe kontrollet përfundimtare që shoqërojnë përlllogaritjen e treguesve të tregtisë jashtme të mallrave, është i mirë trajnuar dhe me përvojën e duhur. Kjo i jep mundësinë stafit që të përftojë një pamje të plotë dhe në vijimësi rreth ndërmarrjeve dhe përgjegjësi të tyre. Proceset janë në gjendje për të monitoruar në mënyrë adekuate cilësinë e statistikave të përpiluara dhe të shpërndara. Njësia ndërmerr rregullisht kontrolle për mbulimin, klasifikimin dhe mungesën e të dhënave. Përveç kësaj, ai monitoron konsistencën e brendshme të të dhënave.

	burimore dhe qëndrueshmërinë në të gjitha burimet e të dhënave. Vlerëson dhe heton të gjitha lëvizjet e pazakonta në të dhënat burimore të marra.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e të dhënave të Tregtisë së Jashtme të Mallrave janë si përdorues të jashtëm dhe të brendshëm. Përdoruesit e jashtëm: • Institucione të administratës publike; • Universitetet; • Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare; • Bizneset; • Kërkues, studentë edhe të tjerë grupe të ngjashme. Disa nga treguesit më të rëndësishëm i dërgohen Komisionit Evropian, Bankës Botërore, FMN-së, OKB-së, etj. Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT të cilët përdorin rezultatet e Tregtisë së Jashtme të Mallrave si input në punën e tyre: • Drejtoria Llogarive Kombëtare; • Drejtoria e Bujqësisë dhe Mjedisit; • Drejtoria e Statistikave Ekonomike; • Sektori i Çmimeve;
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	INSTAT kryen çdo vit vrojtimin për Matjen e Kënaqësisë së Përdoruesve, rezultatet e të cilit do të publikohen në web e INSTAT në linkun Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve. Rezultatet e vrojtimit për 2025 tregojnë se cilësia e përgjithshme e temës "Tregtia e Jashtme e Mallrave" është vlerësuar me 3.03 pikë nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).
12.3. Plotshmëria	Plotshmëria e të dhënave të Tregtisë së Jashtme të Mallrave për vitin 2025 matet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve që prodhon INSTAT kundrejt atyre që kërkohen nga Eurostat. Plotshmëria e të dhënave janë: • Tregtia e Jashtme (mujore) është pjesërisht në përputhje me Eurostat. • Tregtia sipas monedhës është plotësisht e përputhshme me Eurostat. • Tregtia sipas karakteristikave të ndërmarrjeve është pjesërisht e përputhshme me Eurostat.
13. Saktësia dhe besueshmëria	

13.1. Saktësia e përgjithshme	Burimi i vetëm i gabimeve është keqinformimi i bërë nga tregtari në doganë. Sapo tregtari vëren një gabim, ai mund ta korrigjojë atë thjesht me një deklaratë plotësuese. Këto korrigjime pasqyrohen në të dhënat nga INSTAT sa më shpejt të jetë e mundur. Ndikimi i këtyre korrigjimeve në variabla është shumë i vogël.
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet. Të dhënat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave mblidhen nga burime administrative prandaj nuk ka gabime kampionimi. Kontrollët e cilësisë të aplikuara nga INSTAT për të identifikuar gabimet në fushat në vijim: • Shënimet me Kodin e Procedurës Doganore Kombëtare të inicializuara me 'ANU' fshihen pasi ato korrespondojnë me një anulim: është një fazë e ndërmjetme para se statusi 'i anuluar' ti atribuohet artikullit. Shfuqizohen rekordet me kodet e procedurës doganore duke filluar nga 65 (ri-importimi i mallrave të riparuar), 93 (shkatërrimi i mallrave) dhe 99 (humbjet natyrore ose teknike). • Fushat e kodeve: Nomenklatura e kombinuar 8-shifrore, kodet e procedurës doganore, kodet e procedurës doganore kombëtare, kushtet e dorëzimit, kodi i zyrës, mënyra e transportit, kontejneri, vendi, njësia suplementare, tregtari, preferenca, kuota, valuta. • Kodi i NK duhet të jetë në përputhje me Nomenklaturën zyrtare të Kombinuar të vitit. • Partneri nuk mund të jetë Shqipëria përveç deklarimit me CPC '7200', '9600' (hyrja pa taksa) dhe '6910' (Ri-importi i mallrave të eksportuara). • Kushtet e dorëzimit nuk duhet të jenë asnjëherë bosh. • Energjia elektrike ('2716000000') nuk mund të lidhet me një mënyrë tjetër transporti përveç '7- Instalime fikse të transportit '. • Kontrollët e arit monetar në lidhje me kodin CN' 71082000: 'Nëse kodi 71082000 i referohet një sasi të madhe dhe tregtari është BSH, atëherë ajo duhet të përjashtohet nga ITGS, por të përfshihet në të dhënat e dërguara në BSH. Përndryshe ka shumë mundësi të jetë një gabim dhe kodi i mallrave duhet të ndryshohet në ari jo-monetar. • Kodi preferencës nuk është i vlefshëm mbas 2011 ('MTLYU', 'SPA_BE', 'MTLRO', 'MTLKS'). • Dogana duhet të vendosë gjithmonë të njëjtën sasi me kodin e caktuar NK, përndryshe bashkimi i deklaratës nuk do të ketë kuptim për sasinë e SU. Më pas zbatohen testet e mëposhtme: ○ Sasia e SU që gjendet në deklaratë është në SU e kërkuar për kodin NK; ○ Sasia në SU nuk duhet të plotësohet nëse nuk kërkohet nga NK; ○ Nëse fusha e sasisë e SU nuk është e bosh, kodi SU duhet të plotësohet; ○ Nëse plotësohet kodi SU, atëherë sasia nuk duhet të jetë 0. • Pesha neto dhe sasia në njësinë suplementare, nuk mund të jenë të dyja të barabarta me 0. • Pesha neto nuk duhet të jetë më e madhe se pesha bruto.

	Vlera statistikore duhet të jetë mbi 0 kur procedura doganore është e ndryshme nga '7200', '9600' ((hyrja pa taksa) dhe '6910' (ri importimi i mallrave të eksportuara) pasi vlera mund të jetë 0 për të shmangur numërimin e dyfishtë me deklaratën e lidhur).								
13.3. Gabim jo i kampionimit	Nuk disponohen gabime të jo- kampionimit. Burimet e mundshme të gabimeve të jo kampionimit përfshijnë klasifikimet e gabuara të kodeve të mallrave, mos përgjigjen, përgjigjen e vonë, etj.								
14. Afatet kohore dhe përpikmëria									
14.1. Afatet kohore	Rezultatet mujore të Tregtisë së Jashtme të Mallrave janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 17 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 17 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Tregtisë së Jashtme është 31 Dhjetori 2025. <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>31/12/2025</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>19/01/2026</td></tr> <tr> <td>Afatet kohore</td><td>19</td></tr> </table>	Periudha referuese	31/12/2025	Data e publikimit	19/01/2026	Afatet kohore	19		
Periudha referuese	31/12/2025								
Data e publikimit	19/01/2026								
Afatet kohore	19								
14.2. Përpikmëria	Të dhënat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave, publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Tregtisë së Jashtme ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve. <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>31/12/2025</td></tr> <tr> <td>Data e shpallur</td><td>19/01/2026</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>19/01/2026</td></tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td><td>0</td></tr> </table>	Periudha referuese	31/12/2025	Data e shpallur	19/01/2026	Data e publikimit	19/01/2026	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	31/12/2025								
Data e shpallur	19/01/2026								
Data e publikimit	19/01/2026								
Vonesa në kohë	0								
15. Koherenca dhe Krahaseshmëria									
15.1. Krahaseshmëria gjeografike	Dallimet ndërmjet metodologjisë, koncepteve dhe përkufizimeve të përdorura për të mbledhur dhe përpunuar të dhënat mund të ndikojnë në krahasimin e të dhënave mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera.								
15.2. Krahaseshmëria kohore	Gjatë viteve ka shumë ndryshime në lidhje me përkufizimet, mbulimet apo metodat, klasifikimet. Këto ndryshime ndikojnë në krahaseshmërinë me kalimin e kohës, veçanërisht në nivel të detajuar në rastin e ndryshimeve në klasifikim. INSTAT rishikon të dhënat çdo muaj, dhe në rast të ndryshimeve të rëndësishme rishikon të dhënat e mëparshme. Seritë kohore të të dhënave vjetore në baza të qëndrueshme për shumicën e aggregateve janë të krahaseshme nga viti 1991, duke siguruar një krahaseshmëri kohore prej 35 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=35).								

	Seritë kohore të të dhënave mujore në baza të qëndrueshme për shumicën e agregateve janë të krahasueshme nga viti 2005, duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 21 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=21).
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	INSTAT është institucioni zyrtar që publikon statistikat e Tregtisë së Jashtme, bazuar në ligjin e statistikave.
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave, kontrollohet para se të finalizohet. Kontrollohen lidhjet ndërmjet variablave dhe konfirmohet koherenca ndërmjet serive të ndryshme të të dhënave.
16. Kostoja dhe ngarkesa	Personat që punojnë me të dhënat statistikore të Tregtisë së Jashtme janë 2 punonjës + 1 vakant në zyrat qendrore të INSTAT.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit të Tregtisë së Jashtme të Mallrave bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantura nga INSTAT si më poshtë: • Politika e revizionimit; • Politika e trajtimit të gabimeve.
17.2. Praktika e rishikimit	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) u ofron autoriteteve statistikore kombëtare të dhënat e rishikuara për importin dhe eksportin, ku të dhënat statistikore tashmë të ofruara janë ndryshuar. Sektori i Statistikave të Tregtisë së Jashtme rishikon të dhënat çdo muaj dhe rishikimet publikohen në botimin e ardhshëm. Të dhënat përfundimtare për vitin botohen në botimin vjetor, të Statistikave të Tregtisë së Jashtme të Mallrave, të vitit të ardhshëm. Rishikimet e bëra çdo muaj pasqyrohen jo vetëm në botime, por në të njëjtën kohë pasqyrohen dhe në bazën e të dhënave në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT. Nuk ka rishikime deri tani mbi të dhënat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave, për vitin 2025, subjekt i këtij raporti.
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Burim i vetëm për të dhënat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave janë autoritetet doganore. Mallrat e mbuluara nga Dogana përfshijnë energjinë elektrike dhe naftën bruto. Transporti i gazit apo ujit me tubacione nuk janë subjekt i tregtisë ndërkombëtare në Shqipëri. 'Anijet' dhe 'aeroplanët' janë të përfshira në statistikat e Tregtisë së Jashtme të bazuar në deklaratën doganore. Për momentin INSTAT nuk përdor ndonjë burim tjetër informacioni.

18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave mbledhen çdo muaj nga burime administrative.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është përgjegjëse për mbledhjen dhe kontrollin e deklaratave doganore. Të dhënat mbledhen elektronikisht nga zyrat e doganës. Për qëllime statistikore këto të dhëna i dërgohen çdo muaj INSTATit, për kontroll dhe përpunim të dhënash. Të dhënat e përkohshme mujore i jepen INSTAT-it çdo muaj në datën 8 të muajit pasardhës. Të dhënat kontrollohen dhe përpunohen, si dhe publikimi i parë bëhet në datë 17 të çdo muaji në faqen e web-it. Të dhënat jepen aktualisht në format excel në CD (me postë). Nuk ka vonesa në dërgesën e të dhënave.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Përpunimi i të dhënave bëhet me access ku janë të vendosura disa kontrolle të vlefshmërisë së gabimeve, për shembull: Kontrollat në lidhje me vlerën e mallrave që duhet të jetë më të mëdha se 0, pesha neto më e vogël se pesha bruto, njësia e produkteve duhet të jetë e njëjtë me njësinë e përcaktuar në Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave (NK), pesha neto nuk duhet të jetë 0 nëqoftëse ka të përcaktuar njësinë, vendi partner nuk duhet të jetë Al (Shqipëria), korigjime të kodeve të produkteve ose shteteve sipas standardeve të Eurostat, etj.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Që nga marsi 2012 janë vendosur disa kontrolle bazë të të dhënave. DPD kryen disa kontrolle të të dhënave por jo për qëllime statistikore. Këto kontrolle bëhen për qëllime tatimore kështu që të dhënat e marra kanë disa gabime vlefshmërie që korrigjohen nga INSTAT-i. Dogana llogarit vlerën statistikore FOB për eksportet; dhe për importin, kur vlera statistikore është e nënvlerësuar në krahasim me vlerat e dhëna në tabelat e referencës, nëpunësit doganorë aplikojnë një normë rregulluese për të rritur vlerën doganore. Vlera e rregulluar përdoret si vlerë statistikore duke qenë se është më afër realitetit. INSTAT nuk ka një rutinë të rregullt për vlerësimin e vlerës statistikore. Nëse vlera statistikore mungon INSTAT kontakton me doganën për të korrigjuar dhe vendosur vlerën. Në rast se Dogana nuk përgjigjet INSTAT vlerëson vlerën duke përdorur çmimin mesatar të produktit. Të dhëna statistikore nuk përfshijnë natyrën e transaksionit. Dogana është duke hetuar se si ta mbledh këtë të dhënë pasi ky informacion është kërkuar nga disa institucione. Deri tani, nuk është gjetur asnjë mënyrë për të mbledhur këtë të dhënë në sistemin aktual. DPD nuk zbaton thjeshtimin. Transaksionet regjistrohen duke përdorur deklaratat doganore dhe të dhënat përdoren në statistika. Mallrat e Veçantë: • Bimët industriale: DPD nuk përdor procedura thjeshtimi për bimët industriale. Transaksionet regjistrohen sipas kodeve përkatëse të NK. • Anijet dhe aeroplanët: INSTAT përfshin "Anijet" dhe "Aeroplanët" në të dhënat e tregtisë së jashtme bazuar në deklaratat doganore.

	• Mjetet motorrike dhe pjesët e aeroplanëve: INSTAT përfshin "Mjetet motorrike dhe pjesët e aeroplanëve" në të dhënat e Tregtisë së Jashtme bazuar në deklaratat doganore. • Mallrat e dërguara në anije dhe aeroplanë: Mallrat e dërguara në anije dhe aeroplanë konsiderohen si eksport normal. • Produktet e detit: Produktet e detit konsiderohen si eksport normal. • Energjia elektrike dhe gazi: INSTAT përfshin 'Energjinë elektrike' në të dhënat e tij. Të dhënat merren çdo muaj nga DPD. Për momentin tregtia e energjisë elektrike dhe gazit (grupi 271112) regjistrohet nga doganat dhe merret parasysh në tregtinë e Shqipërisë. • Mallrat ushtarake: Nuk ka procedura të veçanta në Doganë për të deklaruar mallrat nën sekretin ushtarak. Konfidencialiteti në nivel kombëtar aplikohet nga Dogana para dërgimit të të dhënave të INSTAT duke zëvendësuar të gjitha kodet e mallrave që i përkasin kapitullit NK 93 me kodin NK 93000000. Ky konfidencialitet është i bazuar në një vendim të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet. Asnjë përshtatje sezonale nuk i bëhet të dhënave të grumbulluara të Tregtisë së Jashtme të Mallrave.
19. Komentet	
Aneks	